



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MEMALIAJ
DREJTORIA E FINANCËS**

Nr. 2550/11 Prot.

Memaliaj, më 12.12. 2025

RELACION

Lënda: Relacion shoqërues mbi Projekt-Buxhetin e Bashkisë Memaliaj për vitin 2026

**KESHILLIT BASHKIAK TE BASHKISË
MEMALIAJ**

Të nderuar anëtarë të Këshillit Bashkiak.

Në mbështetje të neneve 41 dhe 54, të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, nenet 4 e 24 të ligjit 9936 date 26.06.2008 ‘Per Menaxhimin e Sistemit Buxhetor ne Republikën e Shqipërisë’, ligjit 10296 date 08.07.2010 ‘Per Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin’ ne kreun VII -te të ligjit 68 date 27.04.2017 ‘Per Financat e Veteqeverisjes Vendore’, Programit Buxhetor Afatmesem 2026-2028. Shkresa e Ministrise Financave Nr 15867 date 06.11.2025 “Per transferen e pakushtezuar dhe specifike per vitin 2025 Bashkia Memaliaj ka përgatitur Projekt-Buxhetin për vitin 2026 për miratim nga Këshilli Bashkiak.

Ky relacion paraqet një përmbledhje të procesit të ndjekur, analizën financiare dhe arsyetimin e strukturës së të ardhurave dhe shpenzimeve të propozuara.

I. Procesi i hartimit të buxhetit

Procesi i hartimit të buxhetit është realizuar sipas parimeve të transparencës, pjesëmarrjes dhe eficiencës, duke përfshirë:

1. Vlerësimin e të ardhurave vendore për vitin 2026 mbi bazën e realizimit faktik 2023-2024 dhe projeksioneve 2025.
2. Përgatitjen e kërkesave buxhetore nga të gjitha njësitë administrative dhe strukturat e bashkisë.
3. Konsultimet publike, të zhvilluara në datat 3,4,5 dhjetorë 2026 në Njësitë Administrative Buz, Luftinjë, Krahës, Qesarat, dhe qytet Memaliaj.
4. Përgatitjen e projekt-programit buxhetor afatmesëm (PBA) për periudhën 2026–2028.
5. Koordinimin me prioritetet e strategjive vendore dhe dokumenteve të planifikimit.

II Përmbledhje e të ardhurave për vitin 2026

Të ardhurat totale të planifikuara për vitin 2026 janë **362,091 ne (000) lekë**, të ndara si më poshtë:

- **Të ardhura vendore:** **54,000 në (000)lekë**
 - a Të ardhurat nga taksat dhe tarifat 34,000 në (000)lekë
 - b Të ardhura të trashëguara viti 2025 20,000 në (000)lekë
- **Transferta e pakushtëzuar/grandet:** **187,856 në (000)lekë**
- **Transferta specifike / grantet:** **120,235 në (000)lekë**

Analiza e trendit tregon një rritje prej 3.53% krahasuar me vitin 2025(Vlera totale e buxhetit 2025 ne mije leke 349,745) .

III. Përmbledhja e shpenzimeve për vitin 2026

Shpenzimet e planifikuara janë strukturuar sipas programeve dhe artikujve ekonomikë, në total janë **362,091 ne (000) lekë**.

Pjesa kryesore e shpenzimeve ndahet si vijon:

- **Shpenzime korrente:** **300,982 në (000) lekë (600+601+602)**
 - a Shpenzime për paga 217,922 në (000) lekë (600)
 - b Shpenzime për Sig-shoqërore 34,942 në (000) lekë (601)
 - c Shpenzime operative 48,118 në (000) lekë (602)
- **Shpenzime kapitale:** **33,097 në (000) lekë (231)**
- **Fond Rezervë:** **14,084 në (000) lekë (609)**
- **Kontigjenca:** **2,014 në (000) lekë (609)**
- **Fondi i Mbrojtjes Civile :** **2,014 në (000) lekë (609)**
- **Transferta te individ:** **3,900 ne (000) lekë (606)**
- **Transferta të brëndëshme** **6,000 në (000) lekë (604)**

Shpenzimet janë planifikuar duke synuar eficiencë, prioritetet e komunitetit dhe vijimësinë e shërbimeve publike.

IV. Projektet dhe investimet prioritare

Në kuadër të programimit të buxhetit të vitit 2026, Bashkia Memaliaj ka planifikuar investime me vlerë totale 33,097 (në 000 lekë), të financuara nga grantet e trashëguara, transfertat specifike dhe të ardhurat vendore. Programimi i investimeve është hartuar në përputhje me:

Kërkesat e komunitetit të mbledhura gjatë dëgjësave publike.

Detyrimet ligjore dhe kontraktore të bashkisë.

Prioritetet e zhvillimit të territorit.

Kapacitetet financiare të bashkisë.

Përgjegjësitë funksionale sipas programeve buxhetore.

Fondi i investimeve është shpërndarë në projekte me ndikim të drejtpërdrejtë social, ekonomik dhe të shërbimeve publike.

1. Rikonstruksion i Gjimnazit “Sali Nivica” – 10,000.(në 000 lekë)

Ky investim është i detyruar kontraktualisht, pasi Bashkia Memaliaj ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi dhe bashkëfinancimi me Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, ku përcaktohet që bashkia duhet të mbulojë 15% të investimit.

2. Ndërtim lere me plasmas ne kullote ne malin Trebeshine Njesia administrative Luftinje – 2,200. (në 000 lekë)

Financohet nga fondet e transfertës specifike të programit 04260 – Menaxhimi i pyjeve dhe Kullotave ne vleren 1,004(në 000 leke) dhe 1,196 (000 leke) nga te ardhurat vendore ne programin 01110 Planifikim, Administrim,Menaxhim . Ky investimi plotëson një kërkesë të drejtpërdrejtë të komunitetit blegtoral për akses për ujë.

3. Blerje autobetoniere (kamion per perzjerjen dhe transport betoni) – 5,500.(në 000 lekë)
Ky investim rrit kapacitetet teknike të bashkisë për kryerjen e punimeve publike me forcat e veta, ul kostot operative, shpejton ndërhyrjet dhe ndihmon në realizimin e rrugëve me beton, shëtitores dhe punimeve të tjera infrastrukturore.Financohet nga te ardhurat vendore.

4. Rikonstruksion i segmentit rrugor “Rruga Nacionale – Rëra bituminoze Fshati Krahës Nr.2” – ne vlerën 12,350 (në 000)lekë

Ky është një ndër investimet prioritare të komunitetit, i evidentuar në dëgjësat publike. Segmenti ka rëndësi të lartë ekonomike dhe sociale, duke përmirësuar aksesin, lëvizshmërinë dhe zhvillimin e zonave rurale.

5. Blerje mjeti për rulim (rul kompaktor) me vlerë 1,350 ne (000 leke).

Bashkia Memaliaj, në kuadër të përmirësimit të infrastrukturës rrugore rurale, parashikon blerjen e një mjeti për rulim (rul kompaktor). Aktualisht, një pjesë e konsiderueshme e punimeve në rrugët rurale kryhen nga bashkia nëpërmjet Agjencisë së Shërbimeve si njësi vartëse. Bashkia ka në administrim 53 fshatra, të cilat përballen me problematika të vazhdueshme në gjendjen e rrugëve, sidomos në zonat malore dhe ato me fluks të lartë të mjeteve bujqësore.

Blerja e këtij mjeti është e domosdoshme për të siguruar:
cilësi më të lartë të punimeve në mirëmbajtjen dhe ndërtimet e rrugëve rurale;
Rritje të efikasitetit të punës së strukturave të bashkisë;
Ulje të kostove të shërbimeve të kontraktuara ;
Investimi do të financohet nga të ardhurat vendore dhe synon të garantojë një infrastrukturë rrugore funksionale, të qëndrueshme dhe në shërbim të komunitetit në të gjitha njësitë administrative.

6. Mbiqyrje, kolaudime dhe opionenc teknike 1,697 (në 000lekë).keto shpenzime jane te detyrueshme me ligj dhe perbejne element thelbesor te procesit te realizimit te projekteve te investimeve.parashikimi i ketije fondi garanton cilesi,siguri dhe ligjeshmeri .

7. Punime të tjera prioritare .

Përveç investimeve të mësipërme, bashkia do të kryejë me fondet dhe kapacitetet e veta:

- Hapje dhe mirembajtje rrugesh rurale.
- Cakullim rrugësh sipas kerkeseave te fshaterave.
- Punime me beton ne rruge te brendeshme dhe shetitoren e qytetit.
- Nderhyrje te sherbimeve publike në të gjithë territorin.
- Shtrim rrugesh me beton ne varrezat e fshatrave.
- Thurje dhe permiresim i ifrastruktures se varrezave.
- Punime mirembajtjesh shkollash dhe qendrave shendetesore.
- Vendosje dhe mirembajtje sinjalistikes rrugore.
- Ndricimi publik dhe mirembajtja e tije.

Investimet synojnë rritjen e cilësisë së shërbimeve dhe përmirësimin e infrastrukturës jetike në Bashkinë Memaliaj

Për secilin projekt jepen burimet e financimit dhe faza e zbatimit.

V. Qëndrueshmëria financiare

Projekt–Buxheti 2026 garanton balancim ndërmjet:

të ardhurave të sigurta,

detyrimeve të njohura,

vijimësisë së kontratave të shërbimeve,

investimeve strategjike.

Nuk parashikohet tejkalim i kufijve fiskalë të përcaktuar nga MFE.

VI. Kërkesa për miratim

Në përfundim:

Duke konsideruar procesine, ndjekur sipas kuadrit ligjor,pjesëmarrjen e publikut,analizën financiare,përputhshmërinë me programet afatmesme,i propozojmë Këshillit Bashkiak të miratojë Projekt–Buxhetin e Bashkisë Memaliaj për vitin 2026, sipas tabelave të bashkëngjitura.

Bashkëlidhur:

1. Tabelat buxhetore sipas MF.
2. Përmbledhja e konsultimeve publike.
3. Projekt – Buxheti 2026.
4. Shkresa e MF nr. 15867 datë 06.11.2025 (Transferta e pakushtëzuar e përgjithëshme dhe sektoriale për vitin 2026).

